

Karakteristikat e rritjes ekonomike të Kosovës në dekadën e fundit

Bedri HASANAJ

Prishtinë
Janar 2018

Përmbajta

<i>Hyrje</i>	3
<i>Permbledhje Ekzekutive</i>	4
<i>Metodologjia</i>	5
<i>Ekonomia e Kosovës 2008-2016</i>	6
- <i>GDP për kapita dhe GDP në terma nominal</i>	8
- <i>Inflacioni</i>	10
<i>Konsumi</i>	11
- <i>Remitencat</i>	12
<i>Investimet</i>	14
- <i>Investimet e huaja direkte</i>	15
- <i>Investimet qeveritare</i>	16
<i>Neto Eksporti</i>	18
<i>Privatizimi</i>	20
<i>Përfundime dhe rekomandime</i>	21
<i>Referencat</i>	25

Hyrje

Ky punim është bërë si pjese obligative ne lenden “**Mjedisi Biznesor dhe Aspektet Legale**” tek profesori **Alban Hashani** gjatë studimeve master në **Kolegjin Riinvest**.

Tema të cilën do ta shqyrtojmë është “**Karakteristikat e rritjes ekonomike në Kosovë në dekadën e fundit**”. Periudhën për të cilën do të flasim është periudha 2008-2016, pasi që ende BQK dhe ASK nuk kanë publiku disa nga raportet vjetore makroekonomike të vendit për vitin 2017. Analiza do të jetë e bazuar kryesisht ne aspektin makro.

Gjatë hulumtimit të kësaj teme janë konsultuar raporte të:

- ✚ BQK-së (Banka Qendrore e Kosovës)
- ✚ ASK-së (Agjensioni i Statistikave të Kosovës)
- ✚ Institutit Riinvest
- ✚ UNDP-së
- ✚ Ministrisë së Financave dhe
- ✚ FMN-së (Fondi Monetar Ndërkombëtar)
- ✚ AKP-se (Agjensioni Kosovar i Privatizimit)
- ✚ Bankës Botërore
- ✚ Instituti GAP etj

Në pjesën në vazhdim do të analizojmë rritjen ekonomike të Kosovës për këtë periudhë duke analizuar ndaras se si kanë lëviz komponentët e GDP-së si: konsumi, investimet, neto eksporti, inflacioni gjithashtu do të flasim edhe për procesin e privatizimit.

$$\mathbf{GDP = C + I + G + X - M}$$

Permbledhje Ekzekutive

Kosova sikur edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor pas kolapsit të Jugosllavisë kanë ndjekur të njëjtin model të zhvillimit ekonomik, integrimin politik, tregtar, dhe financiar të vendit ne mekanizmat Evropian. Gjatë gjithë kësaj periudhe Kosova i është nënshtruar një politike tërësisht liberale tregtare duke eliminuar barrierat tarifore me nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë si CEFTA dhe MSA, ndërsa ato jotarifore kanë qenë inegzistente.

Në dekadën e fundit Kosova ka pasur rritje ekonomike në mesatare mbi 3%. Rritje kjo e pamjaftueshme për shkak te bazës së vogël te GDP-se. Niveli i informalitetit në Kosovë mbetet i lartë. Vlerësohet se informaliteti është rreth 26-34% të GDP-së. Inflacion ka qene brenda kufijve normal me përjashtim te vitit 2008 dhe 2011 ku inflacioni ka qenë i lartë. Konsumi privat dhe ai qeveritar kanë pasur rritje prej 43%. Kjo ka ndikuar në rritjen e GDP-së edhe pse jo me trend të njëjtë, pasi që konsumin kryesisht e kemi të orientuar në import dhe si e tillë paraja del menjëherë jashtë vendit. Kjo bene qe vlera e multiplikatorit ne ekonomi të jetë e vogël si pasoj edhe ndikimi ne rritjen ekonomike mbetet i vogël. Remitencat janë rritur konstant nga viti ne vit duke ndikuar ne rregullimin e bilancit të pagesave në vend. Investimet në përgjithësi janë rritur për 45%, kryesisht investimet private dhe ato qeveritare. Ndërsa investimet e huaja direkte kanë rënë për 51%. Borxhi publik është rritur nga 249 milion euro apo 6.37% e GDP-se ne vitit 2009 ne 947.5 milion euro apo 15.5% te GDP-se ne vitin 2017. Deficiti tregtar gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje prej 17%. Gjate periudhës së pasluftës ndërmarrjet shoqerore i janë nenshtru privatizimit masiv, (AKM dhe AKP) kanë bërë rreth 1183 shitje të organizuara ne 97 vale të privatizimit. Vlera totale e asete te privatizuara ka qënë rreth 704 milion euro.

Metodologjia

Gjatë kësaj analize kam synuar që objektivin kërkimor ta realizoj me kërkim primar metoda kuantitative dhe sekondar.

Analizën e kemi bërë duke analizuar se si kanë lëvizur komponentët përbërëse të GDP-se si: konsumi, investimet, shpenzimet qeveritare, neto eksporti, inflacioni dhe privatizimi për periudhën kohore 2008-2016. Të gjitha kalkulimet janë bërë duke shfrytëzuar raportet e ASK-së dhe BQK-së në lidhje me ekonominë e vendit gjithashtu janë shfrytëzuar edhe të dhënat nga ASK Data dhe BQK Data. Dokumentet tjera që janë marrë si referencë për këtë punim ja publikimet e Ministrisë së Financave, UNDP-së, Institutit Riinvest, FMN-së Bankës Botërore, AKP-së etj.

1. Ekonomia e Kosovës 2008-2016

Pas luftës së fundit në Kosovë 1998-1999, ekonomia e Kosovës ndryshoi rrënjësisht duke u kthyer nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë . U ballafaqua me sfida të ndryshme që nga ndërtimi i institucioneve e deri tek privatizimi i ndërmarrjeve publike që ishin në pronësi të shtetit. Edhe pse rrjedha e këtij procesi jo rralle herë ka qenë cak i diskutimit, sa i përket domosdoshmërisë se këtij procesi thuhet se ka pasur një konsensus nacional.

Kosova sikur edhe vendet e tjera të Ballkanit përëndimor pas kolapsit të Jugosllavisë kanë ndjekur të njëjtin model të zhvillimit ekonomik i bazuar kryesisht në hapje të tregjeve dhe integrim në Bashkimin Evropian. Ky model synon integrimin politik, tregtar, dhe financiar të vendit. Ndonëse me disa shenja përmirësimi sa i përket rritjes ekonomike, uljes së lehtë të papunësisë dhe stabilitetit makroekonomik e fiskal, situata ekonomike ende karakterizohet me çalime të mëdha në dy drejtime: gjenerimi i deficitit të madh tregtar; dhe niveli i lartë i papunësisë.


Niveli i informalitetit në Kosovë mbetet i lartë, gjë që ka pasoja të mëdha në të ardhurat e buxhetit. Vlerësohet se informaliteti në Kosovë është rreth 26-34% të GDP-së. Të ardhurat që mbesin pa u tatuar zvogëlojnë mundësitë e shtetit për të investuar në fushat prioritare për zhvillim. Gjithashtu, informaliteti dhe mungesa e respektimit të ligjit favorizon bizneset e padrejta dhe jo-inovative, duke e dëmtuar kështu konkurrencën e ndershme dhe zhvillimin e sektorit privat.

Sipas Riinvest (2017) situata ekonomike në Kosovë karakterizohet ende me shpërpjesëtimet makroekonomike të cilat reflektohen para së gjithash në papunësinë e lartë (27-30%) dhe në deficitin e lartë tregtar (30-35% të GDP-së). Rritja ekonomike ka vazhduar gjatë gjithë dekadës së fundit por nuk ka qenë e qëndrueshme dhe as afër nivelit të domosdoshëm karshi sfidave të

zhvillimit të Kosovës. Ndonëse e përmirësuar nga 1.2% në vitin 2014 (2-3% në vitet paraprake) në rreth 4% në dy vjetët e fundit dhe në gjysmën e parë të këtij viti, ende nuk ka arritur nivelin që të adresojë suksesshëm e në mënyrë të qëndrueshme papunësinë dhe diferencat në zhvillim me pjesën tjetër të Evropës. Duket se modeli i deritashëm i rritjes ekonomike nuk mund të servojë rritjen ekonomike që i nevojitet Kosovës.

Siç shihet edhe nga Fig 1. gjatë dekadës së fundit Kosova ka pasur rritje të vazhdueshme ekonomike me një mesatare mbi 3%. Sa është e qëndrueshme kjo rritje dhe sa është domethënëse kur dihet se bazën e GDP-se Kosova e ka të ultë është çështje për diskutim, në të cilën ne nuk do të ndalemi por do të analizojmë vetëm karakteristikat e kësaj rritjeje ekonomike. Me përjashtim të vitit 2012 që Kosova ka pas një rritje prej 1.2%, gjatë gjithë kësaj periudhe rritja reale ekonomike e Kosovës ka qene ne mes 3 dhe 4 %. Rritje kjo e pamjaftueshme për me e kap trendin e hyrëseve të rinj në tregun e punës për shkak të bazës së GDP-së të ultë që e ka vendi. Sipas eksperteve Kosovës i duhet një rritje prej mbi 7% që gjerat të ndryshojnë në vend.

Fig 1. Rritja reale e GDP-së 2008-2016



Burimi: Kalkulim i autorit nga të dhënat e ASK-së.

Fatkeqësisht kjo rritje nuk i ka akomoduar nevojat e tregut të punës në Kosovë. Papunësia vazhdon me mbet shumë e lartë, ku varësisht prej metodologjisë ka ndryshuar kohë pas kohe, mirëpo papunësia sipas ASK-së vazhdon me mbet rreth 27 për qind . Ndërsa papunësia tek të

rinjtë, që është më shqetësuese, është shumë më e lartë, rreth 60 për qind e të rinjve janë të papunë. Ky është një problem i madh për Kosovën, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social. Krahasuar me rajonin Kosova ka ngecë mbrapa për arsye se BPV për kokë banori është më i ulëti në të gjithë regjionin, që tregon se kosovarët janë më të varfër krahasuar me rajonin.

Konsiderohet se me këtë nivel të rritjes ekonomike, Kosova do të përballlet me vështirësi serioze jo vetëm në ballafaqimin me problemet sociale-ekonomike dhe kohezionin social por edhe në integrimin e suksesshëm në BE, me forcimin e pozitës së saj ndërkombëtare si dhe konsolidimit të proceseve të zhvillimit demokratik dhe institucional. Problemet kryesore me të cilat ballafaqohet në këtë periudhë ekonomia e Kosovës janë:


- ✚ Dinamika e pamjaftueshme dhe ritmi jo i qëndrueshëm i rritjes ekonomike.
- ✚ Investimet e pamjaftueshme në krijimin ofertës vendore (produktet dhe shërbimet), veçanërisht në industri përpunuese dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar.
- ✚ Eksporti i vogël, struktura e tij e pavolitshme dhe raportet jo të volitshme dhe jo simetrike tregtare në rajon dhe më gjerë.
- ✚ Modeli i tashëm i zhvillimit dhe rritjes ekonomike ka sjellë deri te një pozitë inferiore të sektorëve prodhues (industrisë përpunuese) në kredi, në eksport, në investimet e jashtme dhe import të pajisjeve.
- ✚ Gjenerimi i pamjaftueshëm i vendeve të punës, papunësia e lartë dhe si rrjedhim ritme të papranueshme të synimeve për emigrim të gjeneratave të reja. (Rinvest, 2017)

1.1 GDP për kokë banori dhe GDP në terma nominal

GDP për kokë banori gjatë dekadës së fundit është rritur nga 2258 euro sa ishte në vitin 2008 në 3387 euro në vitin 2016. Prapë e njëjta mbetet me e ultë në vendet e rajonit.

Sipas ËB (2017) përderisa Kosova gjatë vitit 2016 kishte GDP për kokë banori 3600 dollar, vendet e rajonit kishin këto statistika: Shqipëria, 4209 dollar; Maqedonia, 5060 dollar; Mali i Zi, 6809 dollar; Serbia, 5292 dollar. Pra kemi GDP për kokë banori gati përgjysmë me te vogël se disa vende të rajonit siç është Mali i Zi.


Fig 2. GDP për capita



Burimi: Kalkulimi i Autorit nga të dhënat e ASK-së.

Sa i përket rritjes së GDP-së në terma nominal për këtë periudhe kohore ajo është rritur nga 3.8 miliard euro sa ishte në vitin 2008 në 6 miliard në vitin 2016. Rritja e GDP-së në terma nominal ndër vite është paraqitur në fig 3. Duhet ditur se GDP në terma nominal e përbrendeson edhe inflacionin.

Fig 3. GDP në terma nominal (miliona)




Burimi: Kalkulimi i Autorit nga të dhënat e marruara nga ASK-ja.

1.2 Inflacioni

Inflacioni paraqet rritjen e gjithëmbarshme të çmimeve në një ekonomi, ai nuk paraqet rritjet relative të çmimeve (rritja apo ulja e çmimeve në industri të ndryshme). Pra i referohet rritjes apo uljes së mesatares së të gjitha çmimeve në ekonomi. Për shkak se Kosova nuk ka politik monetare të veten dhe kemi EURO-n si valutë dhe jemi të varur nga importi, mundësia që me kontrolluar inflacionin është e vogël por atë e importojmë varësisht lëvizjeve në tregjet e BE-së. Viteve të fundit BQK ka fillu të lëshoj instrumente financiare siç janë letrat me vlerë ato kryesisht i bënë për financim të aktiviteteve qeveritare dhe jo për shkak të stabilitetit makroekonomik të vendit.

Sipas ASK gjatë gjithë dekadës së fundit Kosova ka pas norma brenda kufijve normal të inflacionit me përjashtim të vitit 2008 dhe 2011 ku inflacioni ka qenë i lartë.

Fig 4. Inflacioni gjatë viteve 2008-2017




Burimi: *Kalkulim i autorit nga të dhënat e ASK-së.*

2. Konsumi

Dihet se konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së popullatës, pra niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien, ndërsa pasuria dhe varfëria varen nga aspekte të tjera në jetë. Të dhënat për konsum merren nga ekonomitë familjare, përderisa të ardhurat fitohen nga individët. Konsumi ka luajtur rol mjaft të rëndësishëm në rritjen ekonomike të Kosovës në dekadën e fundit, madje rritja ekonomike kryesisht ka qenë e bazuar në rritje të konsumit. Siç shihet edhe nga fig 4, që nga viti 2008 konsumi në përgjithësi është rritur për 43%. Rritjen e konsumit e ka mundësuar kryesisht rritja e pagave në sektorin publik, hapja e vendeve të punës në sektorin privat dhe dërgesat e emigrantëve. Pavarësisht rritjes së konsumit kjo nuk ka ndikuar në rritje aq të madhe ekonomike për arsye se konsumin e kemi kryesisht të bazuar në import dhe importi ndikon direkt në uljen e GPD-së duke ju zbritur asaj. Ndërsa indirekt ul vlerën e multiplikatorit në ekonomi duke ndikuar në nxjerrjen e parasë jashtë dhe pamundësimin e saj të qarkulloj brenda vendit.

Fig.4. Konsumi për periudhën 2008-2015(miliona)



Burimi: Kalkulimi i bërë nga autori me të dhënat e marra nga ASK dhe BQK

Sipas ASK (2017) ekonomitë familjare në Kosovë pjesën më të madhe të konsumit e kanë shpenzuar për ushqim, banim, transport, veshmbathje si dhe për alkool dhe duhan. Te shpërndarja e ushqimit në konsum për këtë periudhë dominon mishi, qumështi, djathi, vezët, buka, drithërat dhe perimet. Te ekonomitë familjare urbane dominon konsumi për ushqim, banim, veshmbathje, mobilie dhe alkooli dhe duhani, ndërsa tek ato rurale dominon konsumi për ushqim, banim, transport, veshmbathje dhe alkool dhe duhan.

Rendësi të madhe në rritjen e konsumit të ekonomive familjare në vend kanë pasur remitencat apo parat e dërguara direkt nga mërgimtarët që jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovë.


2.1 Remitencat

Remitencat janë pagesa të rregullta të emigrantëve (punëtorët të cilët dërgojnë para në familjet e tyre në vendin e origjinës).

Flukset hyrëse të remitencave në Kosovë përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme të financimit të huaj, duke dominuar kështu në diskutimet lidhur me burimet e rritjes ekonomike, zbutjes së hendekut të defiçitit tregtar, uljes së nivelit të varfërisë në vend apo tërheqjes së investimeve të huaja. Kjo vëmendje e madhe kushtuar remitencave i atribuohet kryesisht madhësisë së këtyre prurjeve në raport me Bruto Produktin Vendor, natyrës së tyre të qëndrueshme krahasuar me flukset e tjera të financimit të huaj dhe efektit të tyre zbutës të varfërisë dhe papunësisë në vend.

Sipas ASK-së, (2016) familjet Kosovare pranojnë dy lloje të remitencave: ato në formë të parave dhe remitenca në formë të mallrave (veshmbathje, teknologji, makina etj). Ndërsa ekonomia e Kosovës përfiton edhe një lloj të remitencës së tretë, që janë shpenzimet tjera të mundshme që bëjnë vetë bashkatdhetarët gjatë qëndrimit në Kosovë.

Fig 6. Remitencat 2008-2016 (milionat)



Burimi: Kalkulimi i bërë nga autori me të dhënat e marra nga BQK

Remitencat kanë pasur rol crucial në vazhdimësinë e rritje ekonomike të vendit ato kanë ndikuar në: rritjen e të ardhurave të familjare, kjo ka bërë që të rritet konsumi dhe investimet në ekonomi; rritjen e punësimit dhe uljen e presionit ndaj papunësisë; uljen e nivelit të varfërisë në vend; zhvillimin e njohurisë dhe paisjen me njohuri të reja të emigrantëve që kanë lëvizur nga Kosova në vendet e BE-së dhe janë kthyer prap; kanë përmirësuar bilancin buxhetor të vendit etj.


Institucionet e vendit duhet të trajtojnë me kujdes remitencat duke krijuar politika për orientimin e remitencave nga konsumi në investime.

Si të tilla remitencat në të ardhmen mund të kenë efekte të parikuperueshme ekonomike për vendin si: varësia nga remitencat mund të rrezikojë ekonominë e vendit (pasi ekonomia e vendit varet prej krizave në vendet prej nga vijnë remitencat, gjithashtu politikat ndaj të huajve në vendet prej nga vijnë remitencat Kosovës e ekspozojnë në rrezik permanent); humbje e faktorit njeri; vogëlim i motivit dhe përpjekjes për punë nga pranuesit e remitencave; rritja e pabarazisë në të ardhura etj.

3. Investimet

Investimet gjatë dekadës së fundit në përgjithësi kanë pasur trend rritës . Ato nga viti 2008 deri në vitin 2015 janë rritur për 45% në përgjithësi.

Fig. 7. Investimet në Kosovë 2008-2015 (miliona)



Burimi: *Kalkulim i autorit nga të dhënat e ASK-së.*

Në fig 7. janë dhënë investimet në përgjithësi. Këto investime përbëhen nga investimet e sektorit privat vendor, investimet e huaja direkte dhe investimet qeveritare.

Investimet e sektorit privat vendor në përgjithësi janë rritur. Investimet e huaja direkte gjatë kësaj periudhe kanë rënë për 51%. Duhet theksuar se investimet e huaja kryesisht kanë qenë të lidhura me procesin e privatizimit andaj me kalimin e viteve edhe ndërmarrjet e privatizuara në Kosovë kanë qenë më pak.

Në dhjetor 2015, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Investime Strategjike. Ky ligj synon që të lehtësojë procedurat burokratike për investitorët potencialë në Kosovë. Përveç lehtësimit të procedurave, ligji i jep të drejtën Qeverisë së Kosovës të negociojë drejtpërdrejt me investitorë dhe të nxisë investime në rast se ata i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Qëllimi i ligjit thuhet të jetë nxitja e investimeve. Por edhe 2 vite pas miratimit të këtij ligji ende

nuk kemi asnjë kontratë të nënshkruar me ndonjë investitor strategjik që ka përfituar nga ky ligj. Sipas Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike deri tani kemi vetëm 5 aplikacione për të përfituar statusin e investitorit, kryesisht në sektorin e energjisë dhe asnjë kontratë e nënshkruar.


Për të krijuar rritje ekonomike të bazuar në investime dhe të tillë që të jetë e qëndrueshme, Kosova duhet të ndryshojë vizionin ekonomik, në mënyrë që investimet të jenë rreth 30%-32% të BPV-së, dhe të tilla që së paku 2/3 e nivelit të investimeve të jenë nga sektori privat, jo nga ai publik. Nga sektori privat fokus të veçantë duhet t'i jepet investimit në industri dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar, investime në hulumtim dhe zhvillim, në industri prodhuese. Ndërsa sektori publik duhet të fokusohet në investime në kapitalin njerëzor, të tilla në sektorin e arsimit dhe të trajnimeve profesionale (Riinvest, 2017)

3.1 Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte në Kosovë kanë pasur lëvizje nder vite. Tavanin e kanë kap në vitin 2007 kjo kryesisht për shkak të licencimit të operatorit mobil Ipko dhe procesit të privatizimit. Me kalimin kanë rënë edhe investimet e huaja direkte. Ku nga 440 milion sa ishin në vitin 2007, ato kanë rënë në 150 milion në vitin 2014. Secila qeveri rritjen ekonomike të Kosovës e ka pretendu duke rritë investimet e huaja direkte, pasi vendet sikur Kosova që janë në zhvillim e sipër dhe kanë fuqi të lirë punëtore mund të jenë target i këtyre investimeve. Gjatë vitit 2007 12% të GDP totale e përbenin investimet e huaja direkte ndërsa në vitin 2016 ato përbenin veç 3% të GDP-se së vendit. Sipas kalkulimeve të bëra nga BQK Data, shohim se investimet e huaja direkte në fillim kanë qenë të orientuara kryesisht në sektorin financiar, ndërsa viteve të fundit pjesa më e madhe e tyre mbi 50% janë të orientuara në patundshmëri dhe ndërtim ndërsa vetëm 12% në industri të ndryshme (ku impakti i tyre në ekonomi kishte më qenë më i madh)

Viteve të fundit ka pas lëvizje institucionale ne lidhje me rregullimin e ambientit biznesor në vend për ta bërë me të favorshëm për investitor duke bërë ligjin për Investime Strategjike (ligj që parasheh lehtësira ne aspektin regjistrimit, pronës, objektit , energjetike, lirime nga taksat për një periudhë etj). Gjithashtu ka pasur përparim edhe ne klimën e brendshme të bërit biznes, këtë përparim e vë ne dukje edhe raporti i fundit i të bërit biznes i bankës botërore ku Kosovës e rendit në vendin e 40-të (20 vende me mire sesa vitin paraprak), pra shumë me mire sesa vendet e rajonit me përjashtim të Maqedonisë. Por edhe ky raport ve ne dukje sfida siç janë: moszbatimi i kontratave (qe lidhet me funksionimin e gjyqësorit) dhe energjia elektrike. Sfida këto shumë të rëndësishme për një investitor të huaj.

Fig 8. Investimet e huaja direkte 2008-2016 (miliona)




Burimi: Kalkulim i autorit nga të dhënat e BQK-së.

3.2 Investimet Qeveritare

Shpenzimet qeveritare si investime kapitale nga viti 2008 deri në vitin 2013 kanë qenë me trend rritës ndërsa në vitin 2013 ato kanë rënë ndjeshëm. Në përgjithësi gjatë kësaj periudhe shpenzimet qeveritare në investimet kapitale janë rritur për 14.8%. Po qe se i shikojmë si % e GDP-së atëherë vërejmë se investimet kapitale kanë rënë si % e GDP-së. Nga viti 2008 deri ne vitin 2016 GDP e Kosovës është dyfishuar ne terma nominal, ndërsa investimet kapitale qeveritare kanë mbet gati të njëjta me një rritje të lehtë. Kjo për arsye të rritjes së vazhdueshme

të punësuarve dhe pagave ne sektorin publik, rritjes së benefiteve të kategorive sociale, shtimit të kategorive të reja në skemat sociale dhe rritjes së konsumit qeveritar nder vite.

Fig 8. Shpenzimet Qeveritare 2008-2015 (miliona)



Burimi: Kalkulim i autorit nga të dhënat e BQK-së.

Edhe pse investimet kapitale qeveritare ne vend kanë shënuar rënie % e GDP-se gjatë gjithë kësaj periudhe borxhi publik është rritur.

Sipas Ministrisë së Financave (2018) borxhi publik gjatë vitit 2017 ka arritur ne 947.5 milion euro apo përben 15.5% te GDP-se. Borxhi publik i Kosovës akoma është brenda kufijve ligjorë por edhe si i tillë mund të paraqitet problematikë, nëse me kohë nuk parashihen burime të sigurta për kthimin e tyre. Sipas Ligjit për Borxhet Publike, në asnjë rast shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm, nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind të PBB-së.

Borxh ndërkombëtar Kosova kryesisht ka nga: Fondit Monetar Ndërkombëtar FMN, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim BERZH, KfË-ja, Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe UniCredit.

4. Neto Eksporti (Eksporti – Importi)

Njëri ndër problemet më të mëdha që ka ekonomia e Kosovës është bilanci negativ tregtar. Që nga viti 2008 e deri në vitin 2015 deficitin tregtar i Kosovës është rritur për 17%, dhe kjo ka ndikuar negativisht në rritjen ekonomike të Kosovës.


Aftësia e ulët konkurruese e Kosovës në tregun ndërkombëtar manifestohet në bilancin negativ tregtar të vendit. Kjo përbën një nga problemet themelore të rritjes ekonomike dhe zhvillimit. Figura 9 tregon deficitin tregtar, i cili si pjesë e ekonomisë përbën gati 40 për qind të BPV-së në Kosovë. Bilanci tregtar negativ është një manifestim i kapaciteteve të ulëta të prodhimit dhe kërkesës së ulët për eksporte kosovare, pas periudhës së deindustrializimit që e shoqëroi vendin në vazhdimësi nga vitet e 90-ta. Mungesa e kapaciteteve prodhuese ka rezultuar në një strukturë të eksporteve e cila është e kufizuar vetëm në produkte të teknologjisë së ulët, përfshirë kryesisht materialet e papërpunuara, metalet, mineralet dhe plastikën. Baza e pazhvilluar e prodhimit kështu ka krijuar varësi në mallrat që importohen kryesisht nga vendet e rajonit dhe ato të Evropës Perëndimore (Riinvest, 2017)

Ngjashëm me rajonin, sektori i shërbimeve mbetet pjesa më e rëndësishme e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë. Këta sektorë përbëjnë deri në 70 për qind të GDP-së dhe rreth 80 për qind të totalit të punësimit në vend (ASK, 2016). Figura 7. tregon se aktiviteti brenda këtij sektori ekonomik është rritur në vazhdimësi si pjesë e BPV-së.

Edhe pse deficitin tregtar është rritur Kosova ka pasur rritje të ndjeshme të eksporteve të shërbimeve, kjo ka ndikuar në uljen e hendekut në mes të eksporteve dhe importeve të produkteve. Sipas BQK (2017) gjatë vitit 2016 Kosova ka exportuar në total 1.346 milion euro mallra dhe shërbime, prej tyre 1.308 milion shërbime ndërsa vetëm 307 milion produkte.

Siç e shohim edhe nga fig.9 eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë rritur vazhdimisht por me trend më të ultë sesa importi i mallrave dhe shërbimeve. Kjo ka ndikuar që deficitin tregtar të rritet. Ekonomia e Kosovës asesi s'ka arritur të krijojë prodhim të brendshëm për ta zëvendësuar importin, kjo ka bërë që me rritjen e konsumit ndër vite të rritet edhe importi i mallrave dhe shërbimeve dhe siç e dimë importi i zbritet GDP-se totale, kjo e ka ngadalësuar trendin e rritjes së GDP-së. Tani kur po flasim raporti në mes të eksporteve dhe importeve mbetet 1 me 10.

Fig.9 Neto Eksporti 2008-2015 (miliona)



Burimi: Kalkulim i autorit nga të dhënat e ASK dhe BQK

Gjatë gjithë kësaj periudhe Kosova nuk ka përdorur kurrfarë mekanizma tarifor për mbrojtjen e prodhuesve vendor dhe rritjen e kapaciteteve të tyre duke ju nënshtruar një politike krejtësisht liberale tregtare. Fillimisht u aplikua një taks prej 10% në të gjitha importet. Me vonë kjo taks u reduktua në 0 për disa produkte si pjesë e marrëveshjeve për tregti të lirë si: CEFTA, MSA etj. Ndërsa mekanizmat jotarifor për mbrojtjen e prodhuesve vendor kanë qenë inegzistent gjatë kësaj periudhe. Plotësimi i standardeve industriale, lejet, licencimi, certifikimi etj. kanë qenë proceduar standarde të cilave u janë nënshtruar njësoj si importuesit sikur prodhuesit vendor.

5. Privatizimi

Nuk mund të flasim për Ekonominë e Kosovës në periudhën e pasluftës e të mos flasim për procesin e privatizimit në vend. Privatizimit ka qenë ndër proceset më të përfolura në vend, është proces i cili ka filluar menjëherë pas përfundimit të luftës, fillimisht me AKM-në në kohën e UNMIK-ut dhe i vazhduar me AKP-në pas shpalljes së pavarësisë.

Sipas AKP (2018) gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur gjithsejtë 1143 shitje në 97 valë të privatizimit. Fondi i akumuluar është rreth 705 milion euro, prej tyre 119 milion i takojnë fondit të 20%shit të punëtorëve. Ajo çka është diskutuar gjatë gjithë kohës është ngrirja e fondit prej 705 milion euro dhe mos pasja qasje në shfrytëzim të këtij fondi nga ana e institucioneve të Kosovës.

Procesi i privatizimit edhe pse me konsensus të plot politik gjatë gjithë kohës është përcjellë me kritika të ashpra nga shoqëria civile për mënyrën e privatizimit.

Ajo çka mund të thuhet për këtë proces është se privatizimi në Kosovë nuk ka gjenerua vende të punës dhe nuk ka funksionalizuar ndërmarrjet në vend, shumica e ndërmarrjeve të privatizuara me çmime shumë të ulta, kanë përkundë në treg si skrap, apo si toka dhe asnjëherë nuk janë funksionalizuar. Disa prej tyre u është ndërruar veprimtaria nga pronarët e rinj ndërsa një numër i vogël kanë vazhduar veprimtarinë e tyre por me probleme dhe është dashtë ndihma e qeverisë për të shpëtuar nga bankroti (rasti i Sharrcemit dhe Feronikelit). Ky proces është përcjellë me dëbime masive prej punës përderisa është prit të gjeneroi vende të reja të punës.

6. Përfundime dhe rekomandime

Kosova sikur edhe vendet e tjera të Ballkanit perëndimor pas kolapsit të Jugosllavisë kanë ndjekur të njëjtin model të zhvillimit ekonomik i bazuar kryesisht në integrim në Bashkimin Evropian. Ky model synon integrimin politik, tregtar, dhe financiar të vendit në mekanizmat Evropian.

Nga ajo që shtjelluam më lart shikuar se në dekadën e fundit Kosova ka pasur rritje ekonomike në mesatare mbi 3%. Rritje kjo e pamjaftueshme për të ndryshuar gjendjen në vend për shkak të bazës së vogël të GDP-se që e ka Kosova, situata ekonomike ende karakterizohet me çalime të mëdha në dy drejtime: gjenerimi i deficitit të madh tregtar; dhe niveli i lartë i papunësisë.

Kosoves i nevojitet një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse duke u fokusuar më shumë në zhvillimin e shkathtësive, krijimin e vendeve të punës, participim gjithëpërfshirës në tregun e punës, edukim, shëndetësi dhe mirëqenie. Në këtë drejtim emergjente është nevojja e përmirësimit të kualitetit në edukim, si një indikator shumë i rëndësishëm në rritjen e aftësisë konkurruese.

Niveli i informalitetit në Kosovë mbetet i lartë. Vlerësohet se informaliteti është rreth 26-34% të GDP-së

Gjate gjithë dekadës së fundit Kosova ka pas inflacion brenda kufijve normal me përjashtim të vitit 2008 dhe 2011 ku inflacioni ka qenë i lartë.

Konsumi privat dhe ai qeveritar kanë pasur rritje prej 43% gjatë dekadës së fundit . Kjo ka ndikuar në rritjen e GDP-së edhe pse jo me trend të njëjtë, pasi që konsumin kryesisht e kemi të orientuar në import dhe si e tillë paraja del menjëherë jashtë vendit. Kjo bënë që vlera e multiplikatorit në ekonomi të jetë e vogël si pasoj edhe ndikimi në rritjen ekonomike mbetet i vogël.

Remitencat në Kosove janë rritur konstant nga viti ne vit duke ndikuar ne rregullimin e bilancit të pagesave në vend. Remitencat kryesisht janë të orientuara në konsum.

Investimet në përgjithësi gjatë kësaj periudhe janë rritur për 45%, kryesisht investimet private dhe ato qeveritare . Ndërsa investimet e huaja direkte nga viti 2008 deri në vitin 2016 kanë rënë për 51% për arsye se këto investime kryesisht kanë qenë të bazuara në privatizim dhe me rënien e privatizimit kanë rënë edhe ato.

Per te pasur zhvillim ekonomik eshte me rendesi te madhe qe kostoja e transportit te ulet. Per ta ulur koston e transportit Kosova duhet te investoje në infrastrukturën hekurudhore.

Për të krijuar rritje ekonomike të bazuar në investime dhe të tillë që të jetë e qëndrueshme, Kosova duhet të ndryshojë vizionin ekonomik, në mënyrë që investimet të jenë rreth 30%-32% të BPV-së, dhe të tilla që së paku 2/3 e nivelit të investimeve të jenë nga sektori privat, jo nga ai publik.

Nga viti 2008 deri ne vitin 2016 GDP e Kosovës është dyfishuar ne terma nominal, ndërsa investimet kapitale qeveritare kanë mbet gati të njëjta me një rritje të lehtë, ndersa janë përgjysmuar nese shikohen si % e GDP-se. Vendi duhet te krijoj rritje ekonomike të qëndrueshme: duke rritur shkallën e aftësisë konkurruese në sektorin privat, lidhjes përmes zhvillimit të infrastrukturës dhe inkurajimit të një rritjeje ekonomike të bazuar në energji efiçente.

Borxhi publik gjatë gjithë kësaj periudhe është rritur ne vitit 2017 ka arritur ne 947.5 milion euro apo përben 15.5% te GDP-se. Kjo rritje e borxhit i atribuohet kryesisht rritjes se borxhit te jashtëm. Ne vitin 2009 borxhi publik i Kosovës ishte 249 milion euro dhe përbente 6.37% e GDP-se.

Ajo çka paraqitet si problem për ekonominë e Kosovës është deficitit tregtar shumë i lartë. Deficiti tregtarë gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje prej 17% . Pavarësisht se exporti i mallrave dhe shërbimeve është rritur, importi është rritur edhe më shumë. Kur importi është i lartë përpos që ndikon negativisht në rritjen ekonomike, gjithashtu ndikon në nxjerrjen e parasë jashtë tregut, kjo ndikon që vlera e multiplikatorit të jetë e ultë andaj edhe gjenerimi i rritjes ekonomike është më i ultë.

Hendekun në mes të exportit dhe importit me produkte Kosova e ka mbulu me exportin e shërbimeve, ku exporti i shërbimeve është 3fish më i madh se ai i produkteve.

Vendi duhet te mbeshtet nje rritje ekonomike të integruar duke mbështetur tregtinë e lirë dhe politikat e investimeve si dhe ‘lidhjeve’ jodiskriminuese mes ndërmarrësve vendorë dhe të huaj, kontakte transparente dhe të parashikueshme.

Mbështetja e industrisë përpunuese vendore duhet të jetë prioritet duke stimuluar inovacionin dhe rritur aftësinë konkurruese për produktet që gjenerojnë vlerë të shtuar më shumë sesa të produkteve që varen në kosto të punës.

Gjatë gjithë kësaj periudhe Kosova i është nënshtruar një politike tërësisht liberale tregtare ku barrierat tarifore janë eliminu me nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë siç janë CEFTA dhe MSA, ndërsa ato jotarifore kanë qenë inegzistente gjatë gjithë kësaj periudhe.

Gjate periudhës së pasluftës ndërmarrjet ne Kosove i janë nenshtru privatizimit masiv, gjate kësaj periudhe (AKM dhe AKP) kane bere rreth 1183 shitje te organizuara ne 97 vale te privatizimit. Vlera totale e asete te privatizuara ka qene rreth 704 milion euro.

Kosova duhet te zbatoje politika tregtare që sigurojnë konkurrencë të barabartë, përmirësojnë pozitën e eksporteve në raport me barrierat jotarifore dhe zbatimin konsekuent të masave të reciprocitetit.

Ne përgjithësi privatizimi nuk ka gjeneru vende të punës, shumica e ndërmarrjeve janë shite pastaj për skrap dhe u është ndryshuar veprimtaria, disa vetëm janë blere dhe nuk janë funksionalizu asnjëherë e ka të tjera që edhe pse janë funksionalizu qeveria është detyru me ndërhy për ti shpëtuar nga falimentimi.

“Në përgjithësi Kosovës i nevojitet rritje ekonomike gjithëpërfshirëse duke u fokusuar më shumë në zhvillimin e shkathtësive, krijimin e vendeve të punës, participim gjithëpërfshirës në tregun e punës, edukim, shëndetësi dhe mirëqenie. Në këtë drejtim emergjente është nevoja e përmirësimit të kualitetit në edukim, si një indikator shumë i rëndësishëm në rritjen e aftësisë konkurruese”

Referencat

- ASK (2015). *Bruto Produkti Vendor 2008-2014*. Statistikat Ekonomike. [online] Prishtinë: ASK. Available at: <http://ask.rks-gov.net/media/2496/bruto-produkti-vendor-2008-2014.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- ASK (2016). *Bruto Produkti Vendor 2008-2015*. Statistikat Ekonomike. [online] Prishtinë: ASK. Available at: <http://ask.rks-gov.net/media/2404/bpv-2008-2015.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- ASK (2017). *Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016*. Statistikat Sociale. [online] Prishtinë: ASK. Available at: <http://ask.rks-gov.net/media/3343/abef-2016-shqip.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2009). *Raporti vjetor i BQK-së 2008*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2010/BQK%20Raporti%20Vjetor%202008.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2010). *Raporti Vjetor i BQK-së 2009*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://ëë.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Raporti%20Vjetor%202009.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2011). *Raporti Vjetor i BQK-së 2010*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2011/Raporti%20Vjetor%202010.PDF> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2012). *Raporti Vjetor i BQK-së 2011*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-RV%202011-shqip.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2013). *Raporti Vjetor i BQK-së 2012*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-RV-2012.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2014). *Raporti Vjetor i BQK-së 2013*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2014/BQK-RV-Shqip-2013.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].
- BQK (2015). *Raporti Vjetor i BQK-së 2014*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/Raporti%20Vjetor%202014.pdf> [Accessed 28 Jan. 2018].

BQK (2016). *Raporti Vjetor i BQK-së 2015*. [online] Prishtinë: BQK. Available at: [http:// bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK_Raporti%20Vjetor%202015..pdf](http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK_Raporti%20Vjetor%202015..pdf) [Accessed 28 Jan. 2018].

AKP (2017). *Raporti dhe detajet e shitjeve te pronave te NSH-ve*. [online] Prishtine: AKP. Available at: <http://www.pak-ks.org/desk/inc/media/CE0A85B3-05B4-414A-8125-8C17208D728D.pdf> [Accessed 8 Jan. 2018].

Riinvest (2017). *PËRGJIGJE NDAJ SFIDAVE TË RRIJTJES EKONOMIKE. ÇËSHTJET QË E FRENJOJNË ZHVILLIMIN NË KOSOVË*. [online] Prishtine: Riinvest. Available at: http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/02/Prgjigje_ndaj_sfidave_t_rritjes_ekonomike1509614582.pdf [Accessed 8 Jan. 2018].

Ministria e Financave (2017). *TË DHËNAT MBI BORXHIN E PËRGJITHSHËM*. [online] Prishtine: Ministria e Financave. Available at: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/55E134A4-85FB-43DF-AF72-D62E4A79E19C.pdf> [Accessed 12 Jan. 2018].

ASK DATA ne <http://ask.rks-gov.net/>

BQK DATA ne [http:// bqk-kos.org/](http://bqk-kos.org/)